

Permbledhese e njoftimeve per shtyp

- Komisioni i Konkurrences në mbledhjen e tij të datës 05.11.2009, shqyrtoi çështjen me objekt autorizimin e përqendrimit për përfitim e vetëm të kontrollit në shoqërisë Banka Kombëtare Tregtare SHA, nga shoqëria Çalik Finansial Hizmetler AS nëpërmjet blerjes së totalit prej 40% të aksioneve të aksionerëve IFC dhe BERZH. Pas shqyrtimit të ketij transaksioni, Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, shkronjat d, dhe nenin 56, pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” i (ndryshuar), vendosi të autorizojë përqendrimin e realizuar për përfitim e vetëm të kontrollit në shoqërinë Banka Kombëtare Tregtare SH.A, nga shoqëria Çalik Finansial Hizmetler AS nëpërmjet blerjes të aksioneve të zotëruara nga IFC dhe BERZH pasi nuk krijon apo forcon pozitën dominuese në treg.

- Komisioni i Konkurrencës në mbledhjen e tij të datës 19.11.2009, shqyrtoi raportin e Hetimit Paraprak “Mbi sjelljen e ndërmarrjes “ARMO”SHA në tregun e prodhimit dhe tregtimit me shumicë e pakicë të produktit lëndë djegëse për automjete Gazoil (D2)”. Pas shqyrtimit të raportit dhe relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të nenin 24, shkronja d) dhe nenin 43, pika 1, të Ligjit Nr .9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si dhe në nenin 12 dhe nenin 21, pika 4, të Rregullores “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës”, vendosi të hapë procedurat e hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes: “ARMO” SHA; me objekt ekzistencën ose jo të abuzimit me pozitën dominuese në tregun përkatës të produktit lëndë djegëse Diesel D2.

- Komisioni i Konkurrencës në mbledhjen datës 23 /11/ 2009, shqyrtoi çështjen me objekt shqyrtimin e dokumentit të AKEP “Analizë e tregut të telefonisë fikse: Tregjet me pakicë të aksesit dhe thirrjeve telefonike nga vendndodhje fikse dhe tregjet me shumicë të terminimit, origjinimit dhe tranzitimit në rrjete fikse: Konsultim publik”. Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, germa f dhe nenin 70, pika 2 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, me propozim të Sekretariatit, vendosi të rekomandojë AKEP:

1. Të vazhdojë aplikimin e “Metodologjisë së rregullimit të tarifave” derisa tarifa e thirrjeve kombëtare të jetë e krahasueshme (benchmark) me mesataren e tarifave që aplikohen në vendet rajonit dhe vendet anëtare të Bashkimit Evropian.

2. Rregullimin e plotë të tarifave të aplikuara nga Altelekom duke rritur tarifën që janë nën kosto dhe duke rritur tarifën që janë mbi mesataren e vendeve të rajonit duke i orientuar drejt kostos në mënyrë që të mundësohet një konkurrencë efektive mes operatorëve.

3. Pas vlerësimit të kostove të Altelekom në modelin BULRAIC, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare duhet të balancojë tarifën e Altelekom dhe t’i orientojë drejt kostos. Kjo do të shmangte ofrimin e disa shërbimeve nën kosto që eliminojnë konkurrencën në treg dhe nga ana tjetër do të orientonte drejt çmimeve të

drejta disa tarifa që janë te tepruara dhe disa herë më të larta se vendet e rajonit dhe/ose vendet anëtare të Bashkimit Evropian.

4. Ti kërkojë AKEP që në bazë të nenit 70 të ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe nenit 38 të ligjit “Për komunikimet elektronike” të vërë në dispozicion të Autoritetit të Konkurrencës, të gjithë dokumentet që zotëron lidhur me abuzimin e mundshëm me Pozitën Dominuese të Albtelekom Sh.A në tregun e telefonisë fikse, të përshkruar në dokument.

- Komisioni i Konkurrencës në mbledhjen e tij të datës 07/12/2009, shqyrtoi çështjen me objekt miratimin e Udhëzimit “Për vlerësimin e përqendrimeve horizontale” ne zbatim të Ligjit nr 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar). Pas shqyrtimit të draftit të paraqitur dhe diskutimit Komisioni i Konkurrencës vendosi të miratojë Udhëzimin “Për vlerësimin e përqendrimeve horizontale”, i cili është për përdorim të brendshëm ndërsa për palët e interesuara mund të konsultohet ne faqen e internetit të Autoritetit të Konkurrencës.

- Komisioni i Konkurrencës në mbledhjen e tij të datës 07/12/2009, shqyrtoi çështjen me objekt : Miratimin e Udhëzimit “ Për vlerësimin e përqendrimeve jo horizontale dhe konglomerate” ne zbatim të Ligjit nr 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”(i ndryshuar). Bazuar ne Ligjin nr 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 24, shkronja d), dh) Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit vendosi të miratojë Udhëzimin ”Për vlerësimin e përqendrimeve jo horizontale dhe konglomerate” i cili është për përdorim të brendshëm; ate mund ta konsultoni ne faqen tone zyrtare.

- Komisioni i Konkurrencës, , ne mbledhjen e dates 14.12.2009, duke u mbështetur ne Memorandumin e Bashkepunimit nderinstitucional me Entin Rregullator të Energjisë Elektrike dhe pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga ndërmarrjet KESH Sh.A, OSSH Sh.A dhe OST Sh.A në seancën dëgjimore, u shpreh në lidhje me disa rekomandime për Entin Rregullator të Energjisë ne lidhje me tarifat e reja te energjise elektrike për vitin 2010, Komisioni i Konkurrencës i rekomandoi ERE që:
 1. Tarifa e gjenerimit për vitin 2010 të jetë e orientuar drejt kosos së gjenerimit dhe normës së kthimit të kapitalit.
 2. Mbështetur në pikën 5.7, paragrafi i fundit të Modelit të Tregut të Energjisë, çdo fitim neto nga eksportet i KESH Sh.A i parashikuar për vitin 2010, duhet të kihet parasysh që të reflektohet në përfitim të klientëve tariforë.